



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.303/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore: Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me ankesën e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kolaicionit Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Anr.303/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që koalicionit: NISMA-AKR-PD, t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postimit te fotove ne rrjetin social Facebook.

### A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datën 06.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, koalicioni NISMA-AKR-PD, ka vazhduar sponzorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se nga fotografia e postuar në llogarinë e kandidatës për deputete Hyrie Gashi-Kodra, nga radhët e subjektit politik NISMA-AKR-PD, në rrjetin social facebook, përmes të cilës është bërë fushatë zgjedhore.

Prova e vetme e dorëzuar nga ankuesi që është një fotografi e postuar në llogarinë e kandidatit në fjalë në rrjetin social facebook, nuk ka datë të postimit (kur është postuar), pra nuk mund të identifikohet pretendimi i parashtruesit të ankesës se nga ana e subjektit politik

NISMA-AKR-PD, është thyer heshtja zgjedhore përmes veprimit/ sponsorizimit të fushatës zgjedhore me anë të postimit të fotografisë në llogarinë e kandidatit të lartëcekur, në rrjetin social facebook, në mungesë të argumentimit të datës së postimit.

Paneli, vlerëson se në bazë të fotografisë së prezentuar si provë materiale, e cila gjindet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siq përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.303 /2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit  
*Adnan Kanushevi*



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,